



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 1/126
Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 124 dhe 125 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/126
Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet me ndryshime Udhëzimi për Nënshkrimin e Kontratave Publike me Vlerë të Mesme dhe Vlerë të Madhe.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për Inkorporimin e vërejtjeve në tekstin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 3/126
Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 4/126


Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet plotësim-ndryshimi i Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar.
2. Obligohet Bordi për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, të themeloj Grupin Punues për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie.
3. Qeveria do të themeloj "Fondin Inicial" për zbatimin e kësaj Strategjie.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe të gjithë akterët tjerë që kanë obligim për zbatimin e këtij procesi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI


Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 5/126
Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet me ndryshime Rregullorja për themelimin e Zyrës për të Drejtat për Pronën Intelektuale.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për Inkorporimin e vërejtjeve në tekstin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 6/126

Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për heqjen e ndëshkimeve të caktuara për borxhet tatimore të arritura sipas kriterëve të përcaktuara më poshtë:
 - 1.1. Ky vendim vlen për të gjithë tatimpaguesit që bëjnë pagesën e gjitha tatimeve dhe interesit të përlllogaritur në lidhje me periudhat tatimore që përfundojnë në, ose para, 31 dhjetor 2008.
 - 1.2. Pagesat me këste nuk janë të lejueshme për lirim sipas këtij vendimi, i gjithë tatimi dhe interesi obligativ për borxhet tatimore të pranueshme duhet të paguhet me një pagesë të vetme të bërë gjatë periudhës për të cilën ky vendim është në fuqi.
 - 1.3. Tatimpaguesit janë përgjegjës për të siguruar që ata të paguajnë shumën e duhur, duke përfshirë edhe interesin e përlllogaritur për të, dhe duke përfshirë, në datën e pagesës.
 - 1.4. Administrata Tatimore e Kosovës, është përgjegjëse për të siguruar që tatimpaguesit janë të pajisur me informacionin e duhur lidhur me shumën e pagesave të kërkuara, duke përfshirë edhe çdo dispozitë të çdo dokumenti të nevojshëm për të bërë pagesën.
 - 1.5. Lirimi nga borxhi tatimor përfshin të gjitha llojet e ndëshkimeve të të gjitha borxheve tatimore të papaguara për periudhat tatimore që përfundojnë në, ose para, 31 dhjetor 2008, pa marrë parasysh kur borxhi tatimor është vlerësuar.

- 1.6. Për t'u kualifikuar për lirim, duhet të paguhen të gjitha pagesat e tatimeve dhe të interesit pas datës së këtij vendimi, por jo më vonë se 30 nëntor 2010.
- 1.7. Anulimi i ndëshkimeve do të bëhet vetëm pasi të jetë bërë pagesa e tatimeve dhe interesit dhe pagesa është aplikuar në borxhin (-et) tatimor në fuqi.
2. Ministri për Ekonomi dhe Financa do të urdhërojë administratën tatimore të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi menjëherë.
3. Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 7/126

Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet planit operativ për vendosjen e familjeve Romë, Ashkali dhe Egjiptas të zhvendosura brenda vendit, nga kampet e kontaminuara me plumb, Osterode dhe Lugu i Qeshmes.
2. Obligohen të gjitha institucionet e përfshira në plan për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 8/126

Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Drejtues Ndërinstitucional për mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2009-2015 në këtë përbërje:

1.1. Ramë Manaj,	Zëvendëskryeministër	Kryesues;
1.2. Habit Hajredini,	Drejtor i ZQM/ZKM	Zëvendëskryesues;
1.3. Enver Hoxhaj,	Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	anëtar;
1.4. Mahir Yagcilar,	Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	anëtar;
1.5. Bujar Bukoshi,	Ministër i Shëndetësisë	anëtar;
1.6. Srdjan Sentic,	Këshilltar i Kryeministrit/ZQK	anëtar;
1.7. Osman Osmani,	Organizata Joqeveritare Iniciativa 6	anëtar;
1.8. Muharrem Prizreni,	Organizata Joqeveritare Fahri Vraniqi	anëtar;
1.9. Seladin Dudaki,	Qendra e Komitetit Ashkali	anëtar;
1.10. Përfaqësues,	Këshilli Konsultativ për Komunitete	anëtar;
1.11. Përfaqësues,	Avokati i Popullit	anëtar;
2. Komiteti Drejtues Ndërinstitucional do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2009-2015 të miratuar nga Qeveria e Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Kryeministrit, ministritë, institucionet tjera dhe anëtarët e Komitetit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 9/126
Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë Legjislative për vitin 2010

1. Nga Strategjia Legjislative për vitin 2010 shlyhet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për veprimtaritë kërkimore shkencore.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/126

Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 02/31 i datës 27 gusht 2008

1. Në pikën 3.3 të vendimit shtohet edhe:
 - Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/126
Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Të gjithë të kategorizuarit si nëpunësit civil sipas Ligjit për Shërbimin Civil të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës do të përfitojnë mjete financiare në baza mujore, në vlerë prej 30 euro (tridhjetë) bruto.
2. Mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi sigurohen me alokim shtesë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.
3. Me rishikim të buxhetit fondi prej 5,000,000.00 euro (pesë milionë) do të shpërndahet nëpër linja buxhetore për secilën organizatë buxhetore sipas listës së bashkangjitur me këtë vendim.
4. Pagesa e këtyre mjeteve financiare fillon nga data 1 maj 2010, dhe vlen për një periudhë 8 (tetë) mujore, deri më 31 dhjetor 2010.
5. Lista e mjeteve financiare të nevojshme për alokimin në organizatat buxhetore, është pjesë e këtij vendimi.
6. Ky vendim, do të jetë në fuqi deri në fund të vitit 2010. Ministria e Administratës Publike obligohet që deri më 1 nëntor 2010 të përgatis gjithë infrastrukturën e nevojshme për fillimin e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil dhe Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil për të filluar së zbatuari nga 1 janari i vitit 2011.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Ministria e Administratës Publike dhe Ministria për Ekonomi dhe Financa.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 12/126

Datë: 26.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë